VENDIM
Nr.617, datë 14.5.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2008, NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QËNDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për numrin total të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

- Në Ministrinë e Punëve të Jashtme të shtohen edhe 20 punonjës;

b) Numri total i punonjësve buxhetorë, për periudhën janar-korrik 2008, bëhet 104 612 punonjës, ndërsa për periudhën korrik-dhjetor 2008, bëhet 104 125 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja
nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Janar-korrik 2008	Korrik-dhjetor 2008
3	Kryeministria	128	128
	Institucione të tjera qeveritare nga të cilat:	106	106
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	33	33
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36	36
	- Grupi i Mbikëqyrjes	8	8
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9	9
	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20	20
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga e cila:	508	508
	- Drejtoria e Standardeve	18	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nga e cila:	2109	2109
	- Bordet e Kullimit	650	650
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1362	1362
10	Ministria e Financave nga e cila:	3108	3108
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1000	1000
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1630	1630
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	22	22
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	43 707	43 220
	- Universitetet	3833	3833
	- Parauniversitar	38 496	38 496
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1105	1105
13	Ministria e Shëndetësisë	15 408	15 408
14	Ministria e Drejtësisë nga e cila:	4594	4594
	- Avokati i Shtetit	40	40
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	400	400

	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Prona	150	150
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188	188
16	Ministria e Brendshme nga e cila:	13 065	13 065
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11 800	11 800
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	140	140
22	Akademia e Shkencave	45	45
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1 415	1 415
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1 401	1 401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82	82
50	Instituti i Statistikës	169	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25	25
78	Ministria e Integrimit	77	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6	6
	Totali	101 508	101 021
	Totali për institucionet e pavarura	3104	3104
	Totali i punonjësve buxhetorë	104 612	104 125